



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.216/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “IS Company” SH.P.K, me NRB 810609513, me seli Rr. Edit Durham, në Prizren, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati L.M., nga Prishtina, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë. Adresa: Rr. “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lublanës, Kati i V-të, për shkak të anulimit të PSH.nr.779/19 të datës 27.11.2019 pas përfundimit të shqyrtimit kryesorë në seancë publike me datë 07.03.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës, më datë 26.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “IS Company” SH.P.K, me NRB 810609513, me seli Rr. Edit Durham, në Prizren, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me çka ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.779/19 të datës 27.11.2019, **si e pabazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 30.12.2019, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “IS Company” SH.P.K, me NRB, me seli në Prizren, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati L.M., nga Prishtina, ka parashtruar padi

kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë. Adresa: Rr. “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lublanës, Kati i V-të, për shkak të anulimit të PSH.nr.779/19 të datës 27.11.2019, me kërkesë që të anulohet vendimi në pjesën e II të dispozitivit si i kundërligjshëm, të detyrohet e paditura që paditësit t’aj kompensoj dëmin e shkaktuar më vendim të kundërligjshëm, me kamatë prej 8% nga data 21.05.2019. Lënda është evidentuar me nr.A.3123/19.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 216/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit përgatitor me datë 11.08.2023 dhe ndërsa seanca e shqyrtimit kryesor u mbajt me datë 20.10.2023 më përfaqësues të autorizuar të paditësit avokat L.M. sipas autorizimit të datës 07.07.2021 dhe përfaqësues të autorizuar të paditurës N.K. sipas autorizimit të datës 10.08.2023, dhe me datë 07.03.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, me pjesëmarrje të ekspertes B.S., në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt, konform nenit 41 ë LKA-së.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në padi në pretendimet në padi dhe deklaratimet në seancë dhe në fjalë përfundimtare ka deklaruar se vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm dhe është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore paditësi ka qenë i përgjegjshëm andaj është i pa bazuar pretendimi i të paditurës i dhënë edhe në përgjigjen në padi se paditësi ka qenë i papërgjegjshëm. Me datë 27.12.2018 Komuna e Prizrenit si AK ka publikuar njoftimin për kontratë për tenderin lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, shesheve hapësirave të gjelbëruar shtratit të lumë bardhit, largimi i borës në qytet dhe fshatra në Komunën e Prizrenit, me nr. 622-18-9669-221. Paditësit kishte ofertuar sipas kësaj shpallje, por që AK e kishte eliminuar duke përzgjedhur fitues një operator tjetër ekonomik pastaj paditësi ushtron kërkesë për rishqyrtim tek AK, e cila ishte refuzuar ndërsa ndaj vendimit për refuzimi i njëjti kishte ushtruar ankesë në OSHP, pastaj OSHP sipas vendimit nr.PSH.108/19

datë 02.05.2019 aprovon ankesën e paditësit IS Company, anulon njoftimin për dhënie të kontratës të AK-së dhe çështjen e kthen në rivlerësim tek AK. AK përsëri vendos që të eliminoj paditësin të përzgjedh fitues OE të njëjtë ekonomik e ndaj atij eliminimi paditësi ushtron kërkesë për rishqyrtim, kërkesë ajo që i refuzohet nga AK, ndaj atij vendimi paditësi ushtron ankesë në OSHP, OSHP pastaj sipas vendimit PSH.nr.264/19 datë 26.06.2019 aprovon ankesën e paditësit, anulohen për herë të dytë njoftimin për dhënie të kontratës dhe lëndën ia kthen në rishqyrtim për tri llojet.

5. AK në rivlerësim eliminon përsëri paditësi ku e zgjedh fitues OE të njëjtë, ndaj këtij njoftimi ushtron kërkesë për rishqyrtim paditësi e cila kërkesë refuzohet, e ndaj vendimit për refuzim paditësi ushtron ankesë në OSHP. OSHP madje sipas vendimit PSH.469/19 të datës 11.09.2019 aprovon pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit , anulon njoftimin për dhënie të kontratës dhe lëndën ia kthen në rivlerësim tek AK për llot3, ndërsa i vërteton njoftimin për dhënie të kontratës për lot1 dhe lot2.
6. AK në rivlerësim për të katërtën herë përmes letrës standarde për ofertues të eliminuar të datës 21.10.2019 e eliminon paditësin kurse e anulon këtë aktivitet të prokurimit për LOT3 me pretendimit se nuk ka pasur oferte të përgjegjshme, pastaj paditësi ushtron kërkesë për rishqyrtim pastaj ankesë në OSHP, e që kjo e fundit sipas vendimit PSH.nr.779/19 datë 27.11.2019 aprovon pjesërisht ankesën e paditësit kurse vërteton Njoftimin për anulimin e aktivitetin e prokurimit lidhur me LOT3.
7. Paditësi thekson se vendimi i OSHP-së me të cilin vërtetohet Njoftimi për anulimin e aktivitet të prokurimit është vendim i pa ligjshëm sepse paditësi kishte qenë ofertues i përgjegjshëm për këtë lot kjo për shkak se i njëjti e kishte plotësuar edhe kriterin për mjete apo pajisje ashtu siç kërkohej në dosje të tenderit e po ashtu e kishte plotësuar edhe kriterin për njësi tek paramana në tabelën B, ndërsa pretendimet që i kishte pasur AK dhe vetë OSHP se kinse paditësi nuk i kishte plotësuar këto dy kritere janë pretendime të pa bazuara, AK e anulon aktivitetin e prokurimit për LOT3 me pretendimin se të gjitha ofertat e kanë tejkaluar vlerën e parashikuar dhe se oferta e paditësit ishte e jo përgjegjshme.

8. Sa i përket çështjes së vlerës së parashikuar ashtu edhe siç kishte konstatuar OSHP në vendimet e saja paraprake AK nuk e kishte ndarë vlerën e parashikuar prej 4 milion euro, pra nuk e kishte darë në LOTE, që të dihej parashikimi i saktë për Lot1 Lot2 dhe Lot3. OSHP në vendimet paraprake këtë e kishte gjetur si shkelje që e kishte bërë AK sepse AK kishte obligim ligjor që për secilin lot të dihet se sa do të jetë vlera e parashikuar e mjeteve në mënyrë që edhe ofertuesit kur ofertojnë për secilin lot të dinë se me çfarë vlere të ofertojnë. Prandaj konsideron se vendimi i atakuar me të cilin vërtetohet njoftimi i kundërligjshëm i AK-së është përfshirë në shkelje të dispozitave të Ligjit LPP-se dhe atë me nenit 1, 7, 59, 60, 61, 62, 64, 69 dhe 72 të këtij ligji dhe në kundërshtim me nenin 42 të rregullave të udhëzuesit të prokurimit publik.
9. Prandaj i propozon gjykatës të aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, të anuloj vendimi i të paditurës, për shkak se edhe siç konstatohet nga ekspertiza e prokurimit deri te anulimi i tenderit nga ana e të paditurës ka ardhur për shkak të mos përcaktimit të vlerës të Lotëve nga ana e AK- e që ky mos përcaktim kishte shkaktuar mungesë të informacioni edhe për paditësin si ofertues dhe paditësi sikurse edhe operatorët e tjerë në mungesë të informacioneve kanë ofertuar një tejkalim të buxhetit të prezantuar nga ana e AK.

Kundërshtimet e të paditurës

10. Përfaqësuesi i të paditurës, në përgjigje në padi dhe gjatë deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesorë e ka kundërshtuar kërkesëpadinë si të pabazuar, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesë padinë e paditësit IS Company Sh.P.K ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar si dhe ta vërtetoj vendimin e OSHP-së nr.779/19 të datës 27.11.2019, për faktin se OSHP me vendimi e lartë cekur ka vepruar drejtë kur ka njoftuar me vendimin për anulim të aktivitet të prokurimit me titull “Mirëmbajtjeje verore dhe dimërore e rrugëve, shesheve, hapësirave të gjelbëruara, shtratit të lumit Bardh dhe largimi i borës në qytet dhe fshatrat e komunës së Prizrenit Zona e parë”, rivlerësim loto 3 me nr. prokurimit 622-18 173-211, të iniciuar nga autoritet kontraktues Komuna e Prizrenit. Pra këtë aktivitet të prokurimi Komuna e Prizrenit e kishte anuluar në pajtim me nenin 62 të LPP-së si dhe ekzaminimin dhe vlerësimin, krahasimin e ofertave e kishte bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së për faktin se paditësi nuk e kishte plotësuar dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë konfrom

kërkesa të autoritetit kontraktues dhe si i tillë i njëjti nuk ka qenë i përgjegjshëm pasi që i njëjti e kishte tejkalluar vlerën e parashikuar të kontratës.

Provat e administruara

11. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi me nr.PSH.779/19 i datës I Panelit Shqyrtues të OSHP-së me datë 27.11.2019, Vendimi me nr.PSH.469/19 i datës 11.09.2019, Ekspertiza për prokurim e punuar nga ekspertja gjyqësore për prokurim B.S., me datë 06.02.2024 sipas aktvendimit të gjykatës të datës 11.01.2024, Dosja e tenderit për AP më nr.622-18-9669-2-1-1 e datës 26.12.2018 me titull: “Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore e rrugëve, shesheve, hapësirave të gjelbëruara, shtratit të Lumbardhit dhe largim i borës në qytet dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit”

Baza Ligjore

12. **LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**
Neni 1 paragrafi 1 përcakton se *“Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*
13. Neni 6 përcakton Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1 parasheh se *“të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit”.*
14. Neni 7 përcakton, Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminim, paragrafi 1 specifikon se: *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*

15. Neni 59 paragrafi 4 përcakton “*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”,*”
16. Neni 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se “*Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.*

Vlerësimi i gjykatës

17. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklarimeve në padi nga paditësi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Nga provat e administruara gjykata vlerësoi këtë gjendje faktike:
18. Me vendimin e kundërshtuar PSH.nr.779/19 të datës 27.11.2019 të Panelit Shqyrtues të OSHP-së, aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "IS Company" SH.P.K-Prishtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, shesheve, hapësirave të gjelbëruara, të shtratit të lum bardhit dhe largimi i borës në qytet dhe fshatrat e Komunës të Prizrenit-zona për, Riverësimi i lotit 3-te", me nr. të prokurimit: 622-18-173-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues "KK Prizen", vërtetohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, dhe obligohet

Autoriteti Kontraktues ne afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për veprimet e ndërmarra.

19. Lidhur me pretendimin e paditësit se Komuna Prizrenit e ka eliminuar me arsyen se nuk e plotësojmë listën e pajisjeve. Paneli shqyrtues bazuar edhe ne vlerësimin e ekspertit të prokurimit se bazuar ne dokumentacionin e bashkangjitur ne dosje (te përshkruara si me larte) dhe kriterin e kërkuar te AK-së, OE ankues "IS Company" Sh.p.k-Prishtine, nuk i plotëson kriteret e kërkuara për pajisje. Sepse sqaron se kriter i kërkuar nga AK për listën e mjeteve ka qene: Alocisterme (Autobot) - 5 - 10 ton 3 cope, kamione me plugje për bore 1 deri 5 ton 7 cope, Autofshisa per trotuar deri 1.5 ton 3 cope, &. makina për kosite, krasitje: standard 6 copë, Kamion për mbeturina nga parqet etj. 2 ton - 1 cope. Ndërsa ne dosjen e O ankues "IS Company" i njëjti ka ofertuar me këto pajisje: Kamion SISU - Autobote me tabela ... me peshe 14500 kg - nuk e plotëson kriterin (5-10 Ton), Kamion Mercedes (cistern) me tabela ... me peshe 8850 kg - nuk e plotëson kriterin (5-10 ton), Mjet special për spërkatje te trotuareve - me fotografi (nuk posedon ndonjë dëshmi tjetër) Kamion Volvo - autobote me tabela me peshe 8080 kg - e plotëson kriterin 5-10 Ton. Fshese për pastrimin e trotuareve 1200 kg - e plotëson kriterin e kërkuar, Kamion Mercedes (për pastrimin e rrugëve) me tabela ..., me peshe 16000 kg - nuk e plotëson kriterin e kërkuar, Kamion Mercedes (për pastrimin e rrugëve) me tabela ... me peshe 8800 kg - nuk e plotëson kriterin e AK-se, Makine speciale për pastrimin e bores nga trotuaret - ka vetëm fotografi nuk ka ndonjë dëshmi tjetër, Makine për pastrimin e bores Mercedes me tabela ... me peshe bartëse 9670 kg - nuk e plotëson kriterin e kërkuar, Makine për pastrimin e bores Mercedes me tabela ... me peshe bartëse 3350 kg - nuk e plotëson kriterin e kërkuar, Makine për pastrimin e bores Mercedes me tabela ... me peshe bartëse 7813 kg - nuk e ploteson kriterin e kerkuar. Kamion për pastrimin e bores Mercedes Benz me tabela me peshe bartese 2250 kg - e plotëson kriterin e kerkuar, Kamion per pastrimin e bores Unimog me tabela ... me peshe bartese 730 kg - e ploteson kriterin e kerkuar. Kamion për pastrimin e bores Mercedes me tabela ... me peshe bartëse 2590 kg - e plotëson kriterin e kërkuar, Makina për kositje dhe krasitje - vetëm fotografi, prandaj pretendimi se oferta e tij është eliminuar pate drejte nga ana e AK-së, është i pabazuar.
20. Lidhur me pretendimin për plotësimin e paramanës se tabelën B për LOT 3. Paneli shqyrtues konform eksperti profesional te prokurimit sqaron se OE ankues nuk e ka

plotësuar (çmimin për njësi tek paramasa ne tabelën B dhe çdo mos-plotësim i paramases ne gjithë pozicionet 14 aq sa i ka tabela) OE nuk i ka te plotësuar dhe kjo e bën ofertën e papërgjegjshme. Neni 39.8 RRUOPP-se thotë: Lista e cimeve nuk është plotësuar- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshëm - Kusht administrativ, po ashtu neni 41.10 Shumat e korrigjuara në kete mënyre jane te detyrueshme për tenderuesin; nëse nuk i pranon tenderi do te refuzohet. Po ashtu pretendimi për çmime jo normalisht të ulëta është refuzuar si i pabazuar. Ndërsa ka theksuar se Lot3 për shkak të tejkalimit të buxhetit AK ka anuluar procedurën ndërsa oferta e operatori ankues është klasifikuar si e papërgjegjshme.

21. Nga Ekspertiza e datës 06.02.2024 e përgaditur nga ekspertja gjyqësore e prokurimit B.S., me objekt të ekspertizës verifikimi i listës së pajisjeve, çmimi për njësi në paramase, a ka tejkalim të buxhetit te AK-së për shkak të mos përcaktimit të vlerës ne lote nga AK. pas ekzaminimit të dokumentacionit, u konstatuar që Lista e pajisjeve të kërkuara nga AK ne njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit 'Mirëmbajtja Dimërore dhe Verore e rrugëve, shesheve, hapësirave te gjelbëruara, shtratit te lumit dhe largimi i bores ne qytet dhe fshatrat e Komunës se Prizrenit' me nr. te prokurimit 622-18-173-211 për lot 3 janë: Tek III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional- Kërkesa për lot 3: Të këtë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike: Atocistern (Autobot) - 5 - 10 ton 3 copë, kamiona me plugje për bore 1 deri 5 ton 7 copë, Autofshisa për trotuare deri 1.5 ton 3 copë, makina per kositje, krasitie eti: standard 6 copë, Kamionet per mbeturina nga parget eti 2 ton - 1 copë.
22. Gjate ekzaminimit te ofertës se 'IS Company' jane evidentuar këto pajisje: Autobot me targa 04-909-HA me peshe 14500kg- nuk e plotëson kriterin (5-10 ton), Kamion-cisterne me targa 04-514-FK me peshe 8850 kg e plotëson kriterin (5-10 ton), Mjet special per sperkatjen e trotuarev- ka prezentuar vetem fotografi, Kamion dy dyer me targa ... me peshe 8080kg- nuk e ploteson kriterin (1-5 ton), Makine për pastrimin e rrugëve me furqa, Marka Bucher me peshe 4500 kg nuk e plotëson kriterin (1-1.5 ton), Makine për pastrimin e rrugëve, Marka 5800 GN me peshe 1200 kg e plotëson kriterin (1-1.5 ton), Kamion special për pastrimin e rrugës, Marka Mercedes, me targa ... me peshe 16000kg- nuk e plotëson kriterin e kërkuar (1-5 ton), Kamion kipper dy dyer, marka Daimler Benz, me targa ... me peshe bartese 9800kg- nuk e plotëson kriterin (1-

5 ton), Makina speciale per pastrimin e bores nga trotuaret nuk ka deshmi, vetem foto, Kamion kipper dy dyer, marka Daimler Benz, me targa ..., me peshe bartese 9670 kg nuk e ploteson kriterin (1-5 ton), Kamion kipper dy dyer, marka Mercedes Benz me targa ..., me peshe bartese 8350kg nuk e plotëson kriterin (1-5 ton), Kamion kipper dy dyer, marka Mercedes, me targa ..., me peshe bartese 7813 nuk e plotëson kriterin (1-5 ton), Kamion kipper dy dyer, marka Mercessdes Benz, me targa, me peshe bartëse, 2250 kg- e ploteson kriterin (1-5 ton), Kamionete kipper per pastrimin e rrugëve nga bora, marka Unimog, me targa, me peshe bartese 730kg- nuk e plotëson kriterin (1-5 ton), Kamion për pastrimin e bores, marka Mercedes, me targa ..., me peshe bartëse 2590kg- e plotëson kriterin (1 -5 ton), Makina per kositje, krasitje- Është prezantuar pro fatura me 4 makina për kositje dhe 2 prerëse shimshiri, Kamionete dubellkabine, marka Opel, me targa ..., me peshe bartese 2175 kg nuk e plotëson kriterin 2 ton. Eksperti i prokurimit ka konstatuar se nga ekzaminimi i pajisjeve te OE 'IS Company', nuk i ploteson kerkesat e AK lidhur me pajisjet teknike dhe si përfundim pretendimi i tij ankimor është i pabazuar ne këtë pikë.

23. Lidhur me Ekzaminimi i dokumentacionit- Çmimi për njësi ne paramase, Tek tabelat e përshkrimit te çmimeve për lot 3, AK ka përgatitur 5 tabela (tabela A, B, C, D dhe E), ku përfshihet, përshkrimi i aktivitetit/pozicionit, njësia matëse, sasia, çmimi për njësi dhe totali. Operatori Ekonomik, 'IS Company, ne tabelën B- Mirembajja dimerore e rrugeve lidhese te fshatrave me ato regionale ku si aktivitet e ka pastrimin e bores, akullit, kryporja dhe pastrime te tjera ne këtë sezone, nuk e ka plotësuar kolonën 'Çmimi per njesi' - Çmimi ne muaj, për 14 pozicione, aq sa ka gjithsejtw tabela B. Bazuar ne Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP), neni 39- Sqarimi i tenderëve, pika 39.8, Çmimi është kusht administrativ dhe në këtë mënyrë tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Po ashtu këtë interpretim ligjor e mbështet edhe neni 41 i RRUOPP- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, përkatësisht paragrafi 41.10, pika b- Në asnjë rast çmimi për njësi nuk mund te korrigjohet. Ne rast se tenderuesi pretendon se ka bërë gabim ne çmimin për njësi, tenderi i tij do të refuzohet dhe konsiderohet si i tërhequr. Prandaj edhe nga ekzaminimi i përshkrimit te çmimeve për tabelën B, u konstatua se OE ne fjale nuk e ka plotësuar çmimin për njësi ne 14 pozicione dhe si rrjedhojë pretendimi i tij ankimor ishte i pabazuar.

24. Lidhur me ekzaminimin e dokumentacionit, se a ka tejkalim te buxhetit te AK-se dhe mospërcaktimi i vlerës ne Lote nga AK, lidhur me arsyen e eliminimit te Operatorit Ekonomik nga Autoriteti Kontraktues, Komuna e Prizrenit, se oferta e ka tejkaluar çmimin e parashikuar ne lotin e III-te, eksperti konstaton se AK nuk e ka bere përcaktimin e vleres se parashikuar ne lote, mirëpo e ka percaktuar si vlere totale 4.000.000,00€. Eksperti ka konstatuar se në njoftimin per kontrate te dates 27.12.2018, AK tek pika II.1.10) Vlera e parashikuar e kontrates eshte percaktuar 4.000.000,00€, Ndersa tek pika II.1.9) Informacione lidhur me pjeset, AK e ka ndare aktivitetin e prokurimit ne tre pjesë/ lote. Duhet marre parasysh qe gjate përgatitjes permes platformes elektronike, e-prokurimi, platforma ne fjale nuk e lejon ndarjen e vlerës ne Lote, mirëpo e merr si vlere totale. Prandaj u konstatua se ne njoftimin për kontrate nuk mund te përcaktohet vlera e lotëve, mirëpo AK në rastin konkret, tek pika 2.5 e dosjes së tenderit, Seksioni II. Fleta e te Dhenave te Tenderit (FDT), ka mundur dhe është dashur qe te përcaktoje vlerën për secilin lot. Prandaj ka konstatuar ne mungese te informatës për vlerën e parashikuar te loteve ka ardh deri te tejkalimi i buxhetit të pretenduar nga AK.
25. Prandaj, Gjykata vlerëson se nga provat e administruara nuk janë vërtetuar pretendimet e paditësit dhe në bazë të provave të administruara u vërtetua se OE 'Is Company', në aktivitetin e prokurimit 'Mirëmbajtja Dimërore dhe Verore e rrugëve, shesheve, hapësirave te gjelbëruara, shtratit te lumit dhe largimi i bores ne qytet dhe fshatrat e Komunës se Prizrenit' me nr te prokurimit 622-18-173-211, pas ekzaminimit te dokumentacionit konform dispozitave te Ligjit të prokurimit, nuk e ka plotesuar kriteri i dosjes se tenderit për pajisje, nuk e ka plotësuar çmimi për njësi per paramase ne tabelën B ne 14 pozicione, mos përcaktimi i vleres se parashikuar ne lote nga ana e Autoritetit Kontraktues ka shkaktuar mungese te informacioneve për Operatorët Ekonomike ofertues dhe si rrjedhojë ka ndikuar në tejkalim te buxhetit te AK-se.
26. Gjykata vlerëson se edhe përkundër që pretendimi i paditësit se ne mungese te informatës për vlerën e parashikuar te loteve ka ardh deri te tejkalimi i buxhetit të pretenduar nga AK është i bazuar, mirëpo gjykata vlerëson se edhe po të kthehej në rishqyrtim çështja tek e paditura, OE paditës "IS Company" Sh.p.k-Prishtine nuk i plotëson kushtet për kualifikim si oferues i përgjegjshem për shkak se i njejtj pas

ekzaminit të dokumentacionit të ofertuar u konstatua se nuk i plotëson kriteret e kërkuara për pajisje siç janë kërkuar nga AK-së.

27. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.216/22, datë 26.03.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.